



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 223, Datë 30.09.2025

MBI

**NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-S NR. 188, DATË 16.11.2020,
“MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË “IDI 2005” SH.P.K., NË VEPRIMTARINË E
PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC “KAMIÇAN” ME KAPACITET
TË INSTALUAR 1860 KW” I NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; nenit 113 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; si dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.06.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 30.09.2025, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 2524 prot., datë 26.09.2025, të Drejtorisë së Politikave të Burimeve të Rinovueshme, “Mbi disa ndryshime në vendimmarrjet e bordit të ERE-s lidhur me plotësimin e kushteve nga subjektet e licencuar në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike.”,

Konstatoi se:

1. Të dhëna mbi shoqërinë “IDI 2005” sh.p.k.

- Me vendimin nr. 188, datë 16.11.2020, i ndryshuar me vendimet nr. 259, datë 21.12.2021, nr. 209, datë 27.06.2023 dhe nr. 291, datë 09.10.2023, Bordi i ERE-s ka licencuar shoqërinë “IDI 2005” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Kamiçan”, me kapacitet të instaluar 1860 kW, për një afat 30-vjeçar.
- Në vendimin nr. 188/2020, i ndryshuar, në pikën 2 është përcaktuar se: a) Shoqëria “IDI 2005” sh.p.k. duhet të depozitojë në ERE, brenda datës 19.09.2032, kontratën e rinovuar “Për dhënien në përdorim të fondit pyjor dhe kullosor publik” të lidhur me Bashkinë Elbasan, si dhe kontratën e rinovuar “Për dhënien në përdorim të fondit pyjor dhe kullosor publik” të lidhur me Bashkinë Gramsh, ose çdo dokument tjetër që rregullon pronësinë në territorin ku shtrihet projekti i HEC Kamiçan. b) Shoqëria “IDI 2005” sh.p.k. duhet të depozitojë në ERE, brenda datës 29.06.2028, lejen e rinovuar të përdorimit të burimit ujor sipërfaqësor për prodhim hidroenergjie nga HEC “Kamiçan”.

2. Analiza Ligjore dhe Vlerësimi

- Pas ndryshimeve të miratuara me vendimin e bordit të ERE nr. 220, datë 01.09.2022, në Rregulloren “Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.06.2016, është riformatuar neni 9 i rregullores “Formati dhe dokumentacioni për aplikim”, duke shfuqizuar gërmën “g” të pikës 2 të këtij neni, e cila përcaktonte se në dokumentacionin juridik, administrativ dhe pronësor të paraqitur për aplikim përfshihen dhe dokumentet që vërtetojnë pronësinë e aplikuesit në zonat ku do të

shtrihet projekti (kontrata shitblerje, kontrata qiramarrje, akte dhurimi, kontrata premtim shitblerje, marrëveshje me subjekte që kanë në pronësi zonat ku shtrihet projekti për ato veprimtari që përdorin asete për kryerjen e aktivitetit të licencuar).

- Në këto kushte, gërma “a” e pikës 2 të vendimit nr. 188/2020, e cila lidhet me depozitimin e kontratave të qirasë për fondin pyjor dhe kullor publik, nuk gjen më mbështetje në kuadrin rregullator.
- Në përputhje me nenin 113 të ligjit nr. 44/2015, vlerësohet se gërma “a” e pikës 2 të vendimit nr. 188/2020 duhet të shfuqizohet, ndërsa detyrimi i parashikuar në gërmën “b” mbetet në fuqi.

3. Nevoja për Ndryshimin e Vendimit

- Në mbështetje të nenit 113 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, i cili parashikon se një akt administrativ mund të shfuqizohet ose të ndryshohet nga organi publik që ka kompetencën për ta nxjerrë, vlerësohet e nevojshme që pika 2 e vendimit të Bordit të ERE nr. 188, datë 16.11.2020, i ndryshuar, të ndryshohet duke shfuqizuar gërmën “a” dhe duke lënë në fuqi vetëm detyrimin për depozitimin e lejes së rinovuar të përdorimit të burimit ujqor sipërfaqësor.
- Ky ndryshim është i nevojshëm për të harmonizuar vendimin me kuadrin e përditësuar rregullator dhe për të siguruar qartësi në kushtet e licencës së shoqërisë “IDI 2005” sh.p.k..

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Gërma “a” e pikës 2 të vendimit të bordit të ERE nr. 188, datë 16.11.2020, i ndryshuar, shfuqizohet.
2. Pika 2 e vendimit të Bordit të ERE nr. 188, datë 16.11.2020, i ndryshuar, ndryshon dhe bëhet: “Shoqëria ‘IDI 2005’ sh.p.k. duhet të depozitojë në ERE, brenda datës 29.06.2028, lejen e rinovuar të përdorimit të burimit ujqor sipërfaqësor për prodhim hidroenergjie nga HEC ‘Kamëçan’.”
3. Heqja e kushteve nuk përjashton këtë shoqëri nga detyrimi për të ruajtur në vazhdimësi të drejtën e ligjshme të përdorimit të territorit ku shtrihet veprimtaria e licencuar, në përputhje me kontratat përkatëse ose aktet e pronësisë.
4. Drejtoria e Politikave të Burimeve të Rinovueshme, të njoftojë shoqërinë “IDI 2005” sh.p.k., Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, FTL sh.a., dhe OSSH sh.a. lidhur me vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit AHMETI